Vendimi nr. 33, datë 24.06.2010

(V – 33/10)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Vladimir Kristo, Kryetar, Fehmi Abdiu, Kujtim Puto, Xhezair Zaganjori, Petrit Plloçi, Vitore Tusha, Sokol Sadushi, Sokol Berberi, Admir Thanza, anëtarë, me sekretare Blerina Çinari, në datë 03.11.2009 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 23, 24, 25, 29 /14 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: **SHOQATA KOMBËTARE E USHTARAKËVE NË REZERVË,** përfaqësuar nga av.Anastas Duro, me autorizim.

AVOKATI I POPULLIT, përfaqësuar nga Alma Vokopola, Alket Jaupi dhe Sotiraq Nushi, me autorizim.

SINDIKATA E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, përfaqësuar nga av.Thimio Kondi, av.Viktor Ikonomi dhe av.Rigels Konomi, me autorizim.

SHOQATA "ORGANIZATA E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT NË LIRIM", përfaqësuar nga av.Thimio Kondi, av.Viktor Ikonomi dhe av.Rigels Konomi, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

SHOQATA "ALEANCA KOMBËTARE E USHTARAKËVE TË SHQIPËRISË", përfaqësuar nga Kujtim Çaku.

KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga znj.Jonida Tafani dhe z.Bledar Miloti, me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga zj.Marsida Xhaferllari, me autorizim.

MINISTRIA E FINANCAVE, përfaqësuar nga zj. Lindita Rusmali, me autorizim.

MINISTRIA E MBROJTJES, përfaqësuar nga z. Rezart Tërshana, z.Gjergji Pihoni dhe z.Leonard Kryeziu, me autorizim.

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE, përfaqësuar nga z. Ali Emini, me autorizim.

QËNDRA SHQIPTARE E REHABILITIMIT TË TRAUMËS DHE TORTURËS, në mungesë.

O B J E K T I: **1. Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë".**

2. Pezullimi i zbatimit të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë" deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15/1, 17/1,2, 18/1,3, 49/2, 52/1, 131/a, 134/1/"f", 142/3, 166/1, 167/2 dhe 168/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27-31, 45, 49/2 dhe 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë"; neni 24, shkronja "c" i ligjit nr.8454, datë 04.2.1999 "Për

Avokatin e Popullit", i ndryshuar me ligjin nr. 9398, datë 12.05.2005.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Admir Thanza, përfaqësuesit e kërkuesve dhe përfaqësuesin e subjektit të interesuar: shoqata "Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë" që u shprehën për pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara: Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe, pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Ligji nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë" (ligji objekt gjykimi) ndryshoi kuadrin ligjor ekzistues për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve dhe të punonjësve të Policisë së Shtetit në detyrë ose në lirim.

Kërkuesi, Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë, përpara Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) kërkon shfuqizimin e ligjit objekt gjykimi me pretendimin se ai është i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta), pasi bën një rregyllim të ndryshëm përkeqësues nga ligjet e mëparshme: Ligji nr.9210, datë 23.03.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë"; ligji nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr.9418, datë 20.05.2005 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" (të ndryshuar), dhe me vendimin nr.9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto pretendime:

- Ligji objekt gjykimi cenon parimin e barazisë përpara ligjit pasi krijon një diskriminim ndërmjet ushtarakëve që kanë paguar kontributin shtesë prej 2% dhe atyre që

nuk e kanë paguar, ushtarakëve që kanë vjetërsi shërbimi më pak se 15 vjet për burrat dhe 12 vjet për gratë dhe diskriminon ushtarakët që janë dënuar për motive politike, si dhe ndërmjet ushtarakëve dhe qytetarëve të tjerë të Republikës së Shqipërisë.

- Ligji objekt gjykimi cenon parimin e sigurisë juridike pasi zvogëlon të drejtat e fituara nga ushtarakët, cenon vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe u jepet fuqi prapavepruese.

Kërkuesi, Avokati i Popullit, përpara Gjykatës, kërkon shfuqizimin e neneve 3/3, 4/2, 12/1,2,3, 14/1, 22, 27, dhe 29/2 të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 si të papajtueshme me Kushtetutën, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto pretendime:

- Ligji në nenin 27 të tij cenon parimin e barazisë përpara ligjit, pasi diskriminon ushtarakët që janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me burgim, për krime të kryera me dashje, si dhe trajton me kritere të barabarta punonjësit e Policisë së Shtetit me punonjësit e strukturave të tjera, kur në fakt kushtet dhe vështirësitë e punës janë të ndryshme.

- Ligji cenon parimin e sigurisë juridike, pasi zvogëlon të drejtat e fituara nga punonjësit e Policisë së Shtetit, cenon vendimet gjyqësore të formës së prerë, ka fuqi prapavepruese dhe rrit masën e kontributit suplementar që punonjësit e Policisë së Shtetit duhet të paguajnë.

Kërkuesi, Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit, përpara Gjykatës, kërkon shfuqizimin e neneve 3/3, 4/2, 12/1,2,3, 14/1, 22, 27 dhe 29/2 të ligjit 10142, datë 15.05.2009 si të papajtueshme me Kushtetutën, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto pretendime:

- Ligji cenon standardin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42/1 të Kushtetutës, pasi është miratuar në shkelje të hapur të procedurës për miratimin e tij të parashikuar në Rregulloren e Kuvendit.

- Ligji në nenin 27 të tij cenon parimin e barazisë përpara ligjit, pasi diskriminon ushtarakët që janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me burgim, për krime të kryera me dashje.

- Ligji cenon parimin e sigurisë juridike, pasi zvogëlon të drejtat e fituara nga punonjësit e Policisë së Shtetit, cenon vendimet gjyqësore të formës së prerë, ka fuqi

prapavepruese dhe rrit masën e kontributit suplementar që punonjësit e Policisë së Shtetit duhet të paguajnë.

Kërkuesi, shoqata "Organizata e punonjësve të Policisë së Shtetit në lirim", përpara Gjykatës, kërkon shfuqizimin e ligjit 10142, datë 15.05.2009 objekt të gjykimit, si të papajtueshme me Kushtetutën, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto pretendime:

- Ligji cenon standardin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42/1 të Kushtetutës, pasi është miratuar në shkelje të hapur të procedurës të parashikuar në Rregulloren e Kuvendit.

- Ligji është në kundërshtim me nenin 49/2 të Kushtetutës, sepse cenon të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës, pasi pakëson të drejta me karakter ekonomik e social të fituara nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

- Ligji cenon parimin e barazisë përpara ligjit, pasi vendos një lloj barazie në përfitime ndërmjet punonjësve të policisë që kanë grada më të larta dhe që paguajnë më shumë kontribute dhe atyre që kanë grada dhe paga më të ulëta dhe që paguajnë më pak kontribute.

- Ligji cenon parimin e sigurisë juridike, pasi zvogëlon të drejtat e fituara nga punonjësit e Policisë së Shtetit; cenon vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe ka fuqi prapavepruese.

Subjekti i interesuar, shoqata "Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë", depozitoi pranë Gjykatës Kushtetuese një kërkesë për t`u thirrur si subjekt i interesuar. Në vijim të kësaj kërkese kjo Shoqatë është njoftuar nga Gjykata Kushtetuese për t'u paraqitur ditën e seancës. Gjatë seancës, përfaqësuesi i këtij subjekti deklaroi se ky subjekt dëshironte të merrte pjesë në cilësinë e subjektit të interesuar, duke u bashkuar me kërkuesit për antikushtetutshmërinë e ligjit dhe duke parashtruar këto pretendime:

- Neni 30 i ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 shfuqizon dispozita të Ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i cili është një ligj organik që mund të ndryshohet vetëm me një shumicë prej 3/5 votash.

- Ligji cenon parimin e barazisë përpara ligjit, pasi diskriminon ushtarakët, duke i barazuar me përfituesit e tjerë që nuk janë ushtarakë.

- Ligji cenon parimin e sigurisë juridike, pasi cenon të drejtat e fituara nga ushtarakët dhe kufizon masën e pensionit në dy pensione bazë, pavarësisht gradave të përfituesve.

Përfaqësuesit e ***subjekteve të interesuara*** Këshilli i Ministrave, Kuvendi i Shqipërisë,Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës kërkuan rrëzimin e kërkesave, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

- Kërkuesit nuk legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetues. Avokati i Popullit nuk ka interes në çështjen konkrete, kurse kërkuesit e tjerë nuk specifikojnë në kërkesat e tyre dispozitat statutore, në bazë të të cilave këto organizata mbrojnë interesat ekonomikë të anëtarëve të tyre.

- E drejta për përfitim suplementar është një e drejtë që është vlerësuar nga Kuvendi, se meriton mbrojtje me ligj, por ky fakt nuk nënkupton se përfshihet në rrethin e të drejtave kushtetuese dhe të lirive themelore.

- Ligji objekt gjykimi nuk cenon parimin e sigurisë juridike, pasi ai nuk vendos detyrime për shtetasit, por i garanton atyre përfitime suplementare, duke mos prekur nevojat jetike të subjekteve që e kanë fituar më parë këtë drejtë. Ligji objekt gjykimi ndjek një interes publik, pasi zgjerohet kategoria e subjekteve përfitues, rriten përfitimet për disa kategori përfituesish dhe reformohen Forcat e Armatosura sipas standardeve të NATO-s. Ky zgjerim imponon ndryshimin e masës së përfitimit, por jo mohimin e saj, pasi të ardhurat që vijnë nga kontributet e vetë punonjësve kanë nevojë të plotësohen me të ardhura shtesë nga Buxheti i Shtetit. Ligji objekt gjykimi nuk cenon nenin 142/3 të Kushtetutës, pasi nuk anulon përfitimin e pensionit të fituar me vendim gjykate, por thjesht e rillogarit atë.

- Ligji objekt gjykimi nuk cenon parimin e barazisë përpara ligjit, sepse përfitimet llogariten në bazë të pagës referuese, e cila është e ndryshme për nivele të ndryshme të funksioneve shtetërore dhe për pasojë përfitimi është i diferencuar, për shkak të diferencimit edhe në nivelin e kontributeve.

- Ligji objekt gjykimi nuk cenon të drejtën për mbrojtje shoqërore të punës, pasi neni 49 i Kushtetutës nuk mbron të drejtën për përfitime suplementare, por të drejtën e fitimit të mjeteve të jetesës me punë të ligjshme dhe me zgjedhjen e lirë të profesionit dhe vendit të punës.

- Sa i përket pretendimit për cenimin e standardit kushtetues për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42/1 të Kushtetutës, ky pretendim nuk është arritur të provohet nga kërkuesit përpara Gjykatës Kushtetuese.

II

Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim, përpara seancës plenare, kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë". Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", subjekti që kërkon pezullimin e një akti duhet provojë nëse zbatimi i menjëhershëm i tij do të prek interesat shtetërorë, shoqërorë ose të individëve, si dhe pasojat e pariparueshme që do të sillte zbatimi i aktit. Gjykata nuk gjeti argumente bindëse për mundësinë e ardhjes së pasojave të dëmshme për interesat shtetërore e shoqërorë ose të individëve, si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të këtij ligji, në kuptim të nenit 45 të ligjit të sipërcituar. Për këto arsye Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kësaj kërkese.

III

1. Lidhur me pretendimin e subjekteve të interesuara se kërkuesit nuk legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetues

1.1 Për legjitimimin e Avokatit të Popullit

Gjykata vëren se e drejta e Avokatit të Popullit për të iniciuar një gjykim kushtetues ka tashmë një trajtim të qëndrueshëm në jurisprudencën kushtetuese. Avokati i Popullit, si një nga subjektet që mund të vërë në lëvizje Gjykatën, në bazë të nenit 134/2 të Kushtetutës, duhet të justifikojë interesin e tij në çështjen konkrete dhe që lidhet me ushtrimin e funksionit të tij kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme ose të parregullta të organeve të administratës publike. Kur gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave ose njoftimeve që i

paraqiten, Avokati i Popullit evidenton shkelje, nga ato të sipërcituara, rekomandon, nëse është e nevojshme, marrjen e masave me karakter normativ. Krahas kësaj, një mënyrë tjetër, me të cilën ky organ realizon funksionin e tij në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, është dhe vënia në lëvizje e Gjykatës për shfuqizimin e akteve normative, të nxjerra nga organet e administratës publike dhe që rezultojnë të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën. Në raste të tilla, Avokati i Popullit duhet të argumentojë shkeljen konkrete dhe interesin në çështjen që kërkon të shqyrtohet *(Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.40, datë 16.11.2007*).

Për rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se pretendimi i subjekteve të interesuara për mungesë të interesit të Avokatit të Popullit, është i bazuar dhe duhet të pranohet pjesërisht vetëm përsa i takon pretendimit të tij për antikushtetueshmërinë e nenit 27 të ligjit objekt gjykimi. Gjykata vëren se Avokati i Popullit, në kërkesën paraqitur Gjykatës, shprehet se është vënë në lëvizje nga *"Sindikata e punonjësve të Policisë së Shtetit dhe 21 qytetarë (punonjës të Policisë së Shtetit në detyrë dhe ish-punonjës të Policisë së Shtetit, të cilët trajtohen me pagesë kalimtare apo me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi)"*. Gjykata vlerëson se neni 27 i ligjit objekt gjykimi nuk përmban dispozita që rregullojnë të drejtat e punonjësve të Policisë së Shtetit, por të ushtarakëve të Forcave të Armatosura. Në zbatim të vendimeve të saj të mëparshme Gjykata rithekson se Avokati i Popullit mund të vërë në lëvizje këtë Gjykatë vetëm nëse gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave ose njoftimeve që i paraqiten evidenton shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të individëve.

Gjykata Kushtetuese vëren, gjithashtu, se interesi i Avokatit të Popullit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës, duhet të shqyrtohet rast pas rasti. Gjykata Kushtetuese është shprehur dhe më parë në praktikën e saj, se interesi i subjekteve që legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese sipas shkronjave "dh", "e" "ë", "f" të nenit 134 të Kushtetutës, do të quhet i justifikuar nëse arrin të provohet nga vetë kërkuesi se pasoja është e drejtpërdrejtë, pra rrjedh drejtpërdrejt nga akti objekt shqyrtimi, është aktuale dhe, sipas rastit, është e lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit ose të organizatës përkatëse *(Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.40, datë 16.11.2007*). Avokati i Popullit nuk arriti të provojë që të drejtat që rregullohen nga neni 27 i ligjit objekt gjykimi, kanë qenë objekt i veprimtarisë konkrete të tij. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi Avokati i Popullit nuk ka interes për ngritjen e këtij pretendimi. Por Gjykata vlerëson së Avokati i

Populli legjitimohet për ngritjen e pjesës tjetër të pretendimeve që i përkasin cenimit të të drejtave të punonjësve të Policisë së Shtetit, përderisa provon se shkeljet e pretenduara përpara Gjykatës i ka evidentuar gjatë shqyrtimit të ankesave të Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe 21 punonjësve të Policisë së Shtetit në detyrë a në lirim, duke karakterizuar kështu ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë ndërmjet pretendimeve të ngritura përpara Gjykatës dhe funksioneve të tij të parashikuara nga Kushtetuta.

1.2 Për legjitimimin e kërkuesve të tjerë.

Gjykata Kushtetuese ka interpretuar, në jurisprudencën e saj, kriteret kushtetuese për legjitimimin e organizatave si subjekte që mund ta venë atë në lëvizje *(Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 19.03.2008; nr.41, datë 16.11.2007; nr.35, datë 10.10.2007; nr.11, datë 04.04.2007;nr. 9, datë 26.02.2007)*. Shoqatat ose organizatat e tjera janë përcaktuar në nenin 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës si subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre *(Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 10.10.2007)*. Ato kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak.

Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë, shoqata "Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë", Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe shoqata "Organizata e Punonjësve të Policisë së Shtetit në Lirim" janë subjekte juridike të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përkatësisht me vendimet nr.2250, datë 25.03.1996; nr.2644, datë 30.09.2009, nr.3716, datë 17.05.2007 dhe nr.1942, datë 22.04.2007.

Gjykata vëren se sipas statutit të secilit prej kërkuesve të sipërcituar, në objektin e veprimtarisë përfshihet mbrojtja e interesave social-ekonomike të anëtarëve të tyre. Kërkuesit pretendojnë se ligji objekt i këtij gjykimi pranë Gjykatës dëmton interesat ekonomikë të anëtarëve të tyre nëpërmjet pakësimit të përfitimeve suplementare dhe cenimit të të drejtave të fituara. Gjykata vëren se ligji objekt gjykimi parashikon një rregullim të ri të përfitimeve suplementare që gëzohen ose do të gëzohen nga anëtarët e kërkuesve, duke karakterizuar kështu lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Por Gjykata vëren se kjo lidhje

e drejtpërdrejtë nuk ekziston në rastin e pretendimit të ngritur nga kërkuesi Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit përsa i përket cenimit të parimit të barazisë përpara ligjit nga neni 27 i ligjit objekt gjykimi. Gjykata vlerëson se neni 27 nuk përmban dispozita që rregullojnë përfitimet e punonjësve të Policisë së Shtetit, të drejtat e të cilëve mbrohen nga kërkuesi, por vetëm të ushtarakëve të Forcave të Armatosura.

Sa më sipër Gjykata vlerëson se, me përjashtim të pretendimit të Avokatit të Popullit dhe Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit nga neni 27 i ligjit objekt gjykimi, kërkuesit dhe subjekti i interesuar shoqata "Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë" legjitimohen përpara kësaj gjykate për inicimin e këtij gjykimi kushtetues.

2. Lidhur me pretendimin se ligji objekt gjykimi cenon standardin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42/1 të Kushtetutës

Kërkuesit Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe shoqata "Organizata e Punonjësve të Policisë së Shtetit në lirim" ngritën pretendimin në seancë se ligji objekt i gjykimit duhet shpallur antikushtetues, për arsye se është miratuar duke shkelur standardin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42/1 të Kushtetutës. Ata argumentuan se ligji objekt i kërkesës është miratuar në shkelje të hapur të procedurës për miratimin e tij të parashikuar në Rregulloren e Kuvendit (nenet 19, 70 dhe 69 të kësaj Rregulloreje).

Gjykata ka trajtuar në vendimet e saj të mëparshme natyrën juridike të Rregullores së Kuvendit. Gjykata ka vlerësuar se Rregullorja e Kuvendit është një akt juridik në të cilin gjejnë pasqyrim disa dispozita të nivelit kushtetues dhe ka si qëllim të vendosë rregulla mbi veprimtarinë dhe funksionimin e brendshëm të Kuvendit. Gjykata rithekson se Rregullorja e Kuvendit mund të jetë objekt kontrolli kushtetues vetëm nëse janë prekur dispozita të nivelit kushtetues që gjejnë pasqyrim në të. Për çështje të tjera Rregullorja e Kuvendit nuk mund të jetë objekt i një kontrolli të tillë (Shih vendimin nr.35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata e vlerëson të drejtë parashtrimin e subjekteve të interesuara Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi, se shkeljet e pretenduara nga kërkuesit nuk janë të karakterit procedural të nivelit kushtetues, por të karakterit procedural të parashikuar vetëm në Rregulloren e Kuvendit.

Gjithashtu, Gjykata e vlerëson të drejtë parashtrimin e subjekteve të interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi, se kërkuesit në mbështetje të këtij pretendimi nuk arritën të provonin se janë prekur ato pjesë të Rregullores së Kuvendit që cenojnë standardet kushtetuese. Gjykata vëren se kërkuesit madje nuk sollën as provën se i janë drejtuar institucionit të Kuvendit, për të kërkuar shpjegime ose elemente për këto fakte. Në kushtet kur kërkuesit nuk kanë bërë asnjë përpjekje zyrtare për të siguruar provën mbi të cilën mbështesin pretendimin e tyre, nuk i takon Gjykatës të kryejë këto përpjekje në mungesë të një dyshimi të përligjur të krijuar nga elemente konkrete.

Sa më sipër Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky pretendim nuk mund të pranohet.

3. Lidhur me pretendimin se ligji objekt gjykimi shkel nenin 49/2 të Kushtetutës pasi cenon të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës

Kërkuesi shoqata "Organizata e Punonjësve të Policisë së Shtetit në Lirim" pretendon se ligji objekt gjykimi cenon të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës, pasi pakëson të drejta me karakter ekonomik e social të fituara nga punonjësit e Policisë së Shtetit. Kërkuesi shprehet se përmirësimi në mënyrë të vazhdueshme i kushteve të jetesës dhe garantimi i standardeve të arritura përbën një ndër objektivat më të rëndësishëm ekonomiko-social të shtetit tonë, si shtet i së drejtës, demokratik e social.

Gjykata është shprehur se e drejta për pension është një e drejtë që përfshihet në grupin e të drejtave ekonomiko-sociale që për nga natyra janë të drejta pozitive. Prandaj përmbajtja e tyre duhet interpretuar në lidhje të ngushtë me detyrimin e shtetit për t'u bërë aktiv e për t'u garantuar shtetasve sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore në rastet e fatkeqësive, të sëmundjeve, invaliditetit, pleqërisë dhe papunësisë së padëshiruar *(Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.02.2007*).

Gjykata, për vlerësimin e cenimit të së drejtës për mbrojtje shoqërore të punës, nuk mund të shqyrtojë ligjin objekt gjykimi si të shkëputur nga legjislacioni shqiptar në të cilin ai bën pjesë. Ky ligj u njeh përfituesve të drejta suplementare, në formën e pensionit, mbi ato që u burojnë nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Gjykata vëren se ligji objekt gjykimi nuk e ndryshon ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 por ai ul përfitimet suplementare për disa kategori përfituesish.

Gjykata vëren se ligji objekt gjykimi nuk cenon parimin e mbrojtjes shoqërore të punës, pasi asnjë nga përfituesit e ligjit nuk e ka humbur mbrojtjen shoqërore të punës të garantuar nga Kushtetuta.

Kërkuesi ka ngritur pretendimin se përfitimet shoqërore janë zvogëluar, por nuk ka paraqitur argumente për të provuar se ky zvogëlim ka qenë në atë masë sa të konsiderohet mohim i të drejtës për mbrojtje shoqërore të punës. Për këtë arsye ky pretendim është i pambështetur dhe për rrjedhojë duhet rrëzuar.

4. Lidhur me pretendimin se ligji objekt gjykimi cenon parimin e barazisë përpara ligjit, sipas nenit 18 të Kushtetutës

Kërkuesi Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë pretendon se ligji objekt gjykimi krijon një diskriminim ndërmjet ushtarakëve që kanë paguar kontributin suplementar prej 2% dhe atyre që nuk e kanë paguar, si dhe ndërmjet ushtarakëve që kanë vuajtur dënime politike dhe atyre që nuk kanë vuajtur të tilla dënime.

Gjykata thekson se parimi i barazisë, i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, kërkon që të gjithë qytetarët të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Nga ana tjetër, Kushtetuta, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë asaj kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejtë. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, të cilat duhet të jenë të përligjura në mënyrë të arsyeshme dhe objektive *(Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.02.2007; nr.18, datë 29.07.2008).*

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se dallimi në trajtim do të konsiderohet diskriminues, në vështrim të standardeve të nenit 14 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, kur ai *"... nuk ka justifikim të arsyeshëm e objektiv"*, pra kur ai nuk ndjek një "qëllim të ligjshëm" ose kur nuk ekziston *"... marrëdhënie e arsyeshme dhe përpjesëtimore ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet" (Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 09.07.2009; nr.18, datë 29.07.2008).*

Gjykata vëren se ligji i kundërshtuar bën një trajtim të diferencuar ndërmjet ushtarakëve që kanë paguar kontributin suplementar prej 2% dhe atyre që nuk e kanë paguar këtë kontribut, si dhe ndërmjet ushtarakëve që janë dënuar për motive politike dhe

atyre që nuk janë dënuar. Parimi i barazisë përpara ligjit kërkon ndërmjet të tjerave mosdiskriminimin e grupeve në kushte të njëjta të shtetasve pa arsye të përligjura. Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhet trajtim i diferencuar, kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta ose të ngjashme, ose kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet.

Në nenin 5 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" pranohet se ushtarakët e gëzojnë në mënyrë të njëllojtë statusin si ushtarak, pavarësisht nëse kanë paguar kontributin prej 2% ose kanë vuajtur burgim për motive politike prandaj, parimisht, nuk lihet vend për krijimin e ndonjë ndarjeje bazuar në këto kritere.

Gjykata vëren se ligji objekt gjykimi në nenin 14 pika 2 parashikon një masë më të lartë përfitimi të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ushtarakët që kanë paguar kontributin suplementar prej 2%. Gjykata vlerëson se ky diferencim është i mbështetur mbi një kriter të arsyeshëm dhe objektiv në kuptim të standardeve të përmendura më sipër, pasi në nenin 5 të ligjit objekt gjykimi parashikohet se përfitimet suplementare financohen pjesërisht nga Buxheti i Shtetit dhe pjesërisht nga kontributet suplementare të derdhura nga ushtarakët gjatë kohës që ata janë aktivë. Gjykata vlerëson se është i përligjur dhe i arsyeshëm vendimi i ligjvënësit që ushtarakët që kanë kontribuar më shumë gjatë kohës që kanë qenë aktivë të gëzojnë një përfitim më të lartë sesa ata që nuk kanë kontribuar në të njëjtën masë.

Në mbështetje të pretendimit të cenimit të parimit të barazisë përpara ligjit, kërkuesi pretendon, gjithashtu, se ligji objekt gjykimi u mohon të drejtën e përfitimit të pensionit suplementar të pleqërisë atyre ushtarakëve që kanë vjetërsi shërbimi më pak se 15 vjet për burrat dhe 12 vjet për gratë, të njohur me ligjet e mëparshme, ndërkohë që ua njeh këtë të drejtë ushtarakëve të dënuar për motive politike.

Gjykata vëren se ky argument është i pabazuar në ligj, për arsye se në të kundërt nga sa argumenton kërkuesi, ligji objekt gjykimi nuk e lidh përfitimin ose jo të pensionit suplementar të pleqërisë me numrin e viteve të shërbimit në Forcat e Armatosura. Neni 15 i këtij ligji shprehet qartë se *"ushtarakët e Forcave të Armatosura [...] që përfitojnë pension pleqërie, sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Populllore të Shqipërisë" dhe nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet*

shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, gëzojnë të drejtën e një pensioni suplementar pleqërie". Rrjedhimisht ligji objekt gjykimi nuk përjashton nga përfitimi i pensionit suplementar të pleqërisë asnjë ushtarak të Forcave të Armatosura, pavarësisht nga periudha e shërbimit të tij.

I pambështetur është, gjithashtu, edhe argumenti se ligji objekt gjykimi shkel parimin e barazisë përpara ligjit, pasi krijon një diskriminim ndërmjet qytetarëve të tjerë të Republikës së Shqipërisë dhe qytetarit ushtarak, në disfavor të këtij të fundit, duke parashikuar një afat më të shkurtër për tërheqjen e përfitimeve suplementare sesa ai i përfitimeve bazë sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

Gjykata vëren se ligji objekt gjykimi nuk ka të njëjtin objekt me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993. Ligji objekt gjykimi ka si qëllim garantimin e përfitimeve suplementare mbi ato të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993. Gjykata vëren se të dy ligjet garantojnë përfitime të një natyre të ndryshme. Gjithashtu, Gjykata vëren se përfituesit ushtarakë të Forcave të Armatosura përfitojnë në të njëjtat kushte me të gjithë qytetarët e tjerë nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993. Për këto arsye Gjykata e gjen argumentin të pambështetur në ligj.

Kërkuesi shoqata "Organizata e Punonjësve të Policisë së Shtetit në Lirim" pretendoi se ligji objekt gjykimi shkel parimin kushtetues të barazisë përpara ligjit, pasi barazon përfitimet e punonjësve të policisë që kanë grada më të larta dhe paguajnë më shumë kontribute dhe atyre që kanë grada dhe paga më të ulëta dhe paguajnë më pak kontribute. Një pretendim i ngjashëm u paraqit nga subjekti i interesuar shoqata "Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë", e cila pretendoi se ligji objekt gjykimi diskriminon ushtarakët, duke i barazuar me përfituesit e tjerë që nuk janë ushtarakë. Sipas kërkuesve, parimi i barazisë përpara ligjit duhet të interpretohet se përfshin jo vetëm detyrimin e shtetit për të trajtuar në mënyrë të njëjtë situata objektivisht të njëjta ose të ngjashme, por edhe detyrimin për të trajtuar në mënyrë të ndryshme situata objektivisht të ndryshme dhe, në këto kushte, ata nuk mund dhe nuk duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë me kategori të tjera që nuk ndodhen në të njëjtat kushte me ta.

Gjykata është shprehur në vendimet e saj të mëparshme se neni 18 i Kushtetutës *"[...] para së gjithash, sanksionon një detyrim negativ, sipas të cilit shteti duhet të mos ndërhyjë, me qëllim që askush të mos diskriminohet padrejtësisht [...]" (Shih vendimin nr.33, datë 12.09.2007)*. Ky interpretim buron nga vetë natyra e parimit të barazisë përpara ligjit, të sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës, që nënkupton të drejtën për t'u

trajtuar në mënyrë të barabartë, duke u mbrojtur nga diskriminime të pambështetura në një përligjje të arsyeshme dhe objektive. Kërkuesit pretendojnë se parimi kushtetues i barazisë përpara ligjit duhet të interpretohet *in extenso,* duke përfshirë në kuptimin e tij detyrimin e shtetit për të ndërmarrë një rol aktiv në mënyrë që të garantohet trajtimi i ndryshëm i situatave të ndryshme. Gjykata vlerëson se Kushtetuta i imponon ligjvënësit mbrojtjen e barazisë dhe vetëm në raste përjashtimore lejon trajtime të diferencuara. Interpretimi i kërkuesve i jep një kuptim të gabuar parimit të barazisë përpara ligjit, të mbrojtur nga neni 18 i Kushtetutës siç është interpretuar nga kjo Gjykatë në jurisprudencën e saj të mëparshme.

Sa më sipër, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk është i mbështetur në ligj.

5. Lidhur me pretendimin se ligji objekt gjykimi shkel parimin e sigurisë juridike

Kërkuesit pretendojnë se ligji objekt gjykimi shkel parimin e sigurisë juridike, pasi cenon të drejtat e fituara nga ushtarakët e Forcave të Armatosura dhe nga punonjësit e Policisë së Shtetit nga zbatimi i ligjeve të mëparshme dhe të vendimeve të formës së prerë të gjykatave.

Gjykata rithekson se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Jurisprudenca e kësaj Gjykate referon te ky parim konceptin e sigurisë juridike, të së drejtës së fituar dhe të pritshmërive të ligjshme. Siguria juridike është një nga elementët më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës dhe përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Në këtë pikëpamje duhet parë në çdo rast se në çfarë mase dhe deri ku besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm për t'u mbrojtur dhe cilat janë arsyet për një mbrojtje të tillë. Ligjvënësi jo vetëm që ka të drejtë, por është i detyruar të rregullojë, nëpërmjet akteve të veta me hollësi të drejtat e parashikuara në Kushtetutë (S*hih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 19.03.2008; nr.34, datë 20.12.2005; nr.26, datë 02.11.2005*).

Siguria juridike presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve te shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë

me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme *(Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 12.11.2008; nr.9, datë 26.02.2007*).

Gjykata vëren se ligji objekt gjykimi unifikon kushtet dhe masën e përfitimeve suplementare të disa kategorive përfituesish. Gjykata vëren se ky unifikim ka sjellë pasoja pozitive për një kategori përfituesish dhe pasoja negative për një tjetër kategori, prandaj me të drejtë kërkuesit pretendojnë se disa prej dispozitave të ligjit objekt gjykimi cenojnë të drejtat e fituara për një pjesë të ushtarakëve të Forcave të Armatosura dhe të punonjësve të Policisë së Shtetit, duke ulur masën ose kohëzgjatjen e përfitimeve të tyre.

Gjykata vlerëson se, edhe pse kërkuesit pretendojnë shfuqizimin në tërësi të ligjit objekt gjykimi, në vështrimin e saj dispozitat që paraqesin probleme kushtetuese janë neni 14/2, neni 27 dhe neni 29/2 i këtij ligji. Neni 14/2 rregullon masën e pensionit të parakohshëm dhe parashikon se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi kufizohet për personat që nuk kanë paguar kontribute suplementare në dyfishin e pensionit bazë të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", dhe për personat që kanë paguar kontribute suplementare, nuk mund të jetë më i madh se dyfishi i pensionit bazë të pleqërisë, plus 20 % të pagës referuese të muajit të fundit të punës.

Gjykata vëren se neni 27 i ligjit objekt gjykimi përjashton nga përfitimi, duke lenë jashtë rregullimit të këtij ligji ushtarakët që janë nxjerrë në lirim për shkak se janë dënuar me vendim gjyqësor, të formës së prerë me burgim, për krime të kryera me dashje, ndërkohë që neni 29/2 parashikon se pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare, të caktuara në përputhje me ligjet e mëparshme, si edhe ato të caktuara me vendime të gjykatave, pavarësisht nga mosha e vjetërsia në punë, në çastin e fillimit të së drejtës, do të rillogariten sipas rregullave të përcaktuara në ligjin objekt gjykimi.

Pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet në konsideratë të natyrës së punës të ushtarakëve ose punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët, pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me funksionet që ushtronin. Ligjvënësi, duke marrë parasysh këtë konsideratë, parashikoi krijimin e një sistemi përfitimesh suplementare që të garantohet

ruajtja e një niveli të krahasueshëm jetese dhe ekonomik për ushtarakët e Forcave të Armatosura dhe punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilëve u ndërpriteshin marrëdhëniet e punës. Në këtë këndvështrim Gjykata vlerëson se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe pensioni suplementar i pleqërisë janë të drejta, të cilat mbrohen nga parimi i sigurisë juridike.

Gjykata vëren se dispozita e pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr.10142, datë 15.5.2009 objekt gjykimi rregullon masën e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, ndërkohë që dispozita e pikës 2 të po këtij neni rregullon përllogaritjen e masës së këtij pensioni në varësi të faktit nëse përfituesit e tij kanë paguar ose jo kontribute suplementare.

Gjykata thekson se siguria juridike nënkupton, veç të tjerash, edhe mbrojtjen e të drejtave të fituara të personave, të cilët kanë të drejtë të presin në mënyrë të arsyeshme që të drejtat e fituara, nëpërmjet akteve ligjore të vlefshme, t'u garantohen për të gjithë periudhën dhe të zbatohen realisht. Ligji duhet të ofrojë siguri dhe vijimësi me qëllim që individët të mund të kryejnë veprimet në mënyrën e duhur. Duke qenë se këto ligje e vendime perceptohen si burime pritshmërie të ligjshme për individët, ato nuk mund të ndryshohen e shfuqizohen në një fazë të mëvonshme. Ky parim u lejon individëve një lloj mbrojtjeje kundër ndryshimeve të menjëhershme e të pajustifikueshme të rregullave. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, edhe se parimi i sigurisë juridike nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se, nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes i rëndësishëm publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes mund të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike *(Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 26, datë 02.11.2005)*. Gjykata vëren se me rregullimin e ri të bërë nga pika 2 e nenit 14 vendoset një kufizim në masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, duke u vendosur një tavan maksimal. Gjykata vlerëson se vendosja e këtij kufizimi sjell si pasojë uljen e masës së pensionit të parakohshëm për një kategori përfituesish. Kjo ulje mund të jetë e përligjur në funksion të uljes së shpenzimeve buxhetore dhe vështirësive paguese të shtetit, por subjektet e interesuara parashtruan se shpenzimet e Buxhetit të Shtetit për këto përfitime nuk pësojnë ulje nga zbatimi i ligjit objekt gjykimi. Këto subjekte nuk paraqiten përpara Gjykatës asnjë argument bindës që kjo ulje është bërë për arsye të një interesi publik. Nisur nga funksioni dhe rëndësia e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, zvogëlimi i masës së tij ose kufizimi nga neni 14/ 2 e ligjit objekt gjykimi të shumës maksimale që

mund të përfitohet nuk janë veprime që mund të përligjen me interesin e rëndësishëm publik. Për këtë arsye Gjykata çmon se dispozitat e nenit 14/2 të ligjit objekt gjykimi janë në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe të shtetit të së drejtës.

Përsa i përket rregullimit që sjell neni 27 i ligjit objekt gjykimi, pra përjashtimi nga përfitimet i ushtarakëve që janë nxjerrë në lirim për shkak se janë dënuar me vendim gjyqësor, të formës së prerë me burgim, për krime të kryera me dashje, Gjykata vlerëson se kjo dispozitë është një sanksion me natyrë pasurore dhe që për shkak të karakterit të saj strikt, barazohet me dënimin penal. Në nenin 34 të Kushtetutës parashikohet se : "*Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale ...".* Kjo dispozitë kushtetuese sanksionon parimin *"non bis in idem"*: personi nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën shkelje të ligjit. Pikërisht ky përjashtim nga përfitimet suplementare të përfituesve, që janë dënuar nga gjykata për kryerjen e një krimi me dashje është i barabartë me një ridënim për të njëjtën vepër dhe për pasojë bie ndesh me dispozitën kushtetuese të lartpërmendur. Gjithashtu, Gjykata vëren se zbatimi i kësaj dispozite sjell pasoja negative edhe për ata ushtarakë, të cilët pas vuajtjes së dënimit me burgim janë rehabilituar.

Në lidhje me dispozitën e nenit 29 të ligjit objekt gjykimi, Gjykata vlerëson se mund të zbatohet një interpretim pajtues i kësaj dispozite. Ky interpretim është i mundur kur një ligj ose dispozitë ligjore mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë, njëri nga të cilët është në pajtim me Kushtetutën. Kjo metodë kërkon efektet kushtetuese të rezultateve të ndryshme dhe përzgjedh rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat themelore të individëve *(Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 29 datë 31.05.2010*).

Nenit 29 i ligjit objekt gjykimi parashikon rillogaritjen e të drejtave të njohura në zbatim të ligjeve të mëparshme, pra parashikon se pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të pleqërisë të caktuara në përputhje me këto ligje, si dhe ato të caktuara me vendime të gjykatave, pavarësisht nga mosha dhe vjetërsia në punë, në çastin e fillimit të së drejtës do të rillogariten, pra këto dispozita mund të prekin, duke ulur/pakësuar ose duke rritur të drejtat e fituara. Gjykata thekson se nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese.

Gjykata ka theksuar, në jurisprudencën e saj, se rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuara në Kushtetutë dhe shoqërimi i tyre me masat për vënien në jetë të tyre duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave, forcimin e shtetit të së drejtës *(Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.02.2007; nr.34, datë 20.12.2005*). Parimi i shtetit të së drejtës përmban në vetvete edhe detyrimin e autoriteteve publike për të vënë në ekzekutim vendimet gjyqësore të formës së prerë. Siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykatat kanë vendosur përfundimisht për një çështje, vendimet e tyre nuk duhet të vihnt në dyshim *(Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 24, datë 12.11.2008*). Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe askujt nuk i lejohet të vërë në diskutim njohjen dhe vlerën e vendimeve apo të refuzojë zbatimin e tyre, pasi ato kanë marrë formë të prerë (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.20, datë 09.07.2009; nr.9, datë 01.05.2009, nr.6, datë 06.03.2009; nr.1, datë 19.01.2009; nr.6, datë 31.03.2006; nr.11, datë 27.05.2004*).

Në konsideratë të këtyre përcaktimeve, Gjykata vlerëson se qëllimi i dispozitave të nenit 29 të ligjit objekt gjykimi, duke u nisur nga konteksti i saj, si dhe konteksti i përgjithshëm i këtij ligji, është që kjo rillogaritje e këtyre të drejtave të fituara në zbatim të ligjeve të mëparshme ose dhe të vendimeve të gjykatave, do të bëhet vetëm në rast se ndryshon pozitivisht, pra përmirëson situatën e përfituesve. Në asnjë rast nuk lejohet që të kryhet një rillogaritje që do të çonte në përkeqësimin e situatës pozitive ose në cenimin e të drejtave të fituara. Në rast të kundërt, pra nëse do të bëhej një interpretim dhe zbatim ndryshe i kësaj dispozite, atëherë do të ishim përpara cenimit të parimit të sigurisë juridike. Nga subjektet e interesuara nuk u dhanë argumente për të justifikuar cenimin e sigurisë juridike për një interes të rëndësishëm publik. Qëllimin e mbrojtjes së sigurisë juridike e ka pasur parasysh dhe ligjvënësi, duke parashikuar në nenin 24 paragrafi i parë të ligjit objekt gjykimi se përfitimet suplementare, pasi janë llogaritur, nuk janë më objekt të ndonjë ndryshimi me përjashtim të indeksimit të bërë me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjykata, bazuar në këtë interpretim pajtues, arrin në përfundimin se neni 29 i ligjit 10142, datë 15.05.2009 është i pajtueshëm me Kushtetutën, me kusht që dispozitat e tij të interpretohen si më sipër. Asnjë interpretim tjetër i këtyre dispozitave nuk është i lejueshëm nga pikëpamja kushtetuese dhe se mbrojtja e të drejtave të fituara nuk mund të

arrihet në rast se dispozitave të kundërshtuara u jepet një kuptim tjetër. Duke u nisur nga interpretimi i mësipërm, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kjo dispozitë nuk cenon parimin e sigurisë juridike.

Sa më sipër, Gjykata vlerëson se neni 14/2 dhe neni 27 i ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë", janë të papajtueshme me Kushtetutën, sepse cenojnë parimin e sigurisë juridike dhe si të tilla ato duhen shfuqizuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja "f" dhe "g", neni 134, pika 1, shkronja "ë" të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të pikës 2 të nenit 14, si dhe të nenit 27 të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë".

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.